KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 5168 Prot.
Datë,më 13.06.2025

Partia
Demokratike

**KOALICIONI PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE**

*Tiranë, më 7 Maj 2025*

| | |
|---|---|
| <u>Drejtuar</u>: | Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) |
| <u>Lënda</u>: | Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht, *kërcënimi dhe përdorimi i burimeve njerëzore për veprimtari politike ose zgjedhore dhe përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore nga Eduart Shalsi* |
| <u>Subjekti:</u> | Eduart Shalsi |
| <u>Baza Ligjore</u>: | Kushtetuta e RSH; Nenet 123/1, 123/2, 123/3 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve" |

*I nderuar z. Komisioner,*

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM paraqet kërkesën si vijon në mbrojtje të interesave të saj në këto zgjedhje, pasi vlerësojmë se po cënohemi në të drejtat tona për zhvillimin e një gare të ndershme, të lirë dhe të barabartë përsa i përket zgjedhjeve për Kuvend të datës 11.05.2025.
Kodi Zgjedhor në nenin 123/1 "E drejta për të vënë në lëvizje KQZ-në" parashikon se:

> "*1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së....*".

Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM ka marrë dijeni se Drejtuesi politik i Qarkut Kukës për Partinë Socialiste Eduart Shalsi dhe kandidati për deputet i kësaj force politike janë fotografuar në ambientet e Drejtorisë së policisë së Qarkut Kukës. Kemi marrë dijeni se në këtë mbledhje punonjësve të policisë ju është bërë presion për të votuar kandidatët e Partisë Socialiste më 11 maj.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon:

"*Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore*

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. **Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.** Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim".

Në këtë rast, efektivët e policisë konsiderohen burime njerëzore në kuptim të kësaj dispozite dhe ata janë duke u kërcënuar për shkak të funksionit publik për të mbështetur Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj.

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM kërkon nga ana institucioni juaj marrjen e masave të menjëhershme për personat e përmendur në këtë denoncim.

Bashkëlidhur këtij denoncimi gjeni foto dhe link.

https://www.syri.net/politike/785906/shkelja-e-ligjit-shalsi-mbledh-policine-e-kukesit-ndash-presion-per-votat/

Në këto kushte, Partia Demokratike – Koalicioni PD-ASHM po paraqet zyrtarisht këtë kërkesë lidhur me denoncimin e veprimeve të përmendura më sipër që vijnë në kundërshtim me parimet demokratike dhe rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, **duke kërkuar përfundimisht**:

1) **Nisjen e hetimit administrativ për këtë rast nga administrata e KQZ; si dhe**
2) **Marrjen e masave administrative përkatëse ndaj këtyre veprimeve antiligjore, sipas legjislacionit në fuqi.**

*Duke ju falenderuar paraprakisht,*

PËR KOALICIONIN
PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE
Përfaqësuesi i PD-ASHM në KQZ

Marash LOGU

Syri.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet e fundit?
(HTTPS://WWW.SYRI.NET/ENGLISH/)
EDICIONI I KOSOVËS (/SYRI_KOSOVA/)



syri
(https://www.syri.net/)

ILIR KALEMAJ
**Rama 4 dhe një histori deja vù**
(https://www.syri.net/op-ed/794594/rama-4-dhe-nje-histori-deja-vu/)

IRENA BEQIRAJ
**'Luigji I, Mbreti i Deleve' dhe varësia nga pushteti!**
(https://www.syri.net/op-ed/794355/luigji-i-mbreti-i-deleve-dhe-varesia-nga-pushteti/)









# Shkelja e ligjit/ Shalsi mbledh Policinë e Kukësit – Presion për votat

f
(https://www.facebook.com/sharer/sharer.php?
u=https%3A%2F%2Fwww.syri.net%2Fpolitike%2F785906%2Fshkelja-
(https://twitter.com/intent/tweet?
text=Shkelja+e+ligjit%2F+Shalsi+mbledh+Policin%C3%AB+e+Kuk%C3%ABsit+%E2%80%93+Presion+p%
(https://api.whatsapp.com/send?
text=Lexo:
https%3A%2F%2Fwww.syri.net%2Fpolitike%2F785906%2Fshkelja-
LEXO:
HTTPS%3A%2F%2FWWW.SYRI.NET%2FPOLITIKE%2F785906%2FSHKELJA-

14:53, 06/05/2025

A A A

Drejtuesi politik i Qarkut Kukës për Partinë Socialiste Eduard Shalsi dhe kandidati për deputet i kësaj force politike janë fotografuar në ambientet e Drejtorisë së policisë së Qarkut Kukës.

POLICINE-
KUKESIT-
NDASH-
PRESION-
PER%2F)
VOTAT%2F)
Syri.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet e fundit?
PO
JO

Kjo sjellje është në kundërshtim të hapur me ligjin elektoral. Pasi nuk kuptohet se çfarë bën drejtuesi politik i një force politike në ambientet e Policisë sidomos gjatë një fushate elektorale.

LEXO EDHE:
**Përplasje ligjore në Urdhrin e Psikologut - Grimçi: I kanë bërë llogaritë gabim nëse mendojnë se do uzurpojnë institucionin**
(https://www.syri.net/politike/794842/perplasje-ligjore-ne-urdhrin-e-psikologut-ndash-grimci-i-kane-bere-llogarite-gabim-nese-mendojne-se-do-uzurpojne-institucionin/)

Kjo nuk ka asnjë shpjegim tjetër veçse presion për votat e 11 majit. Ata kanë mbledhur efektivët duke bërë presion punonjësve të policisë për të votuar kandidatët e rilindjes më 11 maj.

Kjo është një shkelje flagrante e ligjit elektoral dhe organet ligjzbatuese duhet të hetojnë këto veprime të drejtuesit politik të PS Kukës.



© SYRI.net







ARTIKULL JOETIK?
(https://aleancaetike.media/raporto-syri-net/)

**Lexo edhe:**


**Ekspertja: Mendoj se duan ta monopolizojnë tregun e kriptovalutave, nuk duhet të jetë i paligjshëm (https://www.syri.net/politike/794853/ekspertja-mendoj-se-duan-ta-monopolizojne-tregun-e-kriptovalutave-nuk-duhet-te-jete-i-paligjshem/)**


**Berisha në SPAK: Ky është institucioni i bashkëpunimit me krimin! Dora e mafies, dora e qeverisë është kudo (https://www.syri.net/politike/794851/berisha-ne-spak-ky-eshte-institucioni-i-bashkepunimit-me-krimin-dora-e-mafies-dora-e-qeverise-eshte-kudo/)**


**Përfundoi në spital, Rama shfaqet në gjendje të rënduar pas farsës elektorale: Jam gjallë, do sjell Yamal-in këtu (https://www.syri.net/politike/794846/perfundoi-ne-spital-**

## më të lexuarat

**Berisha publikon pamjet e transformimit të Spiropalit: Kjo është 'Metamorfoza' e vërtetë, jo ajo e Pëllumb Gjokës**
(https://www.syri.net/politike/794627/berisha-publikon-pamjet-e-transformimit-te-spiropalit-kjo-eshte-metamorfoza-e-vertete-jo-ajo-e-pellumb-gjokes/)